



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.205/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes materialeve promovuese të kandidatit të tyre në shtyllat që ndajnë rrugën nga trotuari, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

#### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.205/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes materialeve promovuese të kandidatit të tyre në shtyllat që ndajnë rrugën nga trotuari në hyrje të FSHMN-së, si dhe përballë fakultetit të Kimisë, përgjatë rrugës Agim Ramadani.

#### A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 03.10.2019 rreth orës 08:00, në Komunën e Prishtinës, saktësisht te hyrja e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, janë parë materiale promovuese të kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Besian Mustafa. Këto materiale janë të ngjitura nëpër shtyllat që ndajnë rrugën nga trotuari, dhe janë në hyrje të FSHMN-së, si dhe përballë fakultetit të Kimisë, përgjatë rrugës Agim Ramadani. Besian Mustafa, në zgjedhjet parlamentare, në listën e LDK-së, mbanë numrin 7, dhe vendosja e tillë e këtyre materialeve është në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenit 3 pika 3. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tyre si provë ka bashkangjitur disa fotografi.

Në plotësim përgjigje në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka bashkangjitur disa fotografi ku shihen se e kanë evituar shkeljen e cekur në ankesë, pa dhënë ndonjë spjegim shtesë nga ana e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se pretendimin e paraqitësit të ankesës, lidhur me atë se materiale promovuese të kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Besian Mustafa, janë vendosur nëpër shtyllat që ndajnë rrugën nga trotuari, dhe janë në hyrje të FSHMN-së, si dhe përballë fakultetit të Kimisë, përgjatë rrugës Agim Ramadani, është i pabazuar, ngase nga fotografitë e paraqitura si dëshmi nga ana e ankuesit nuk mund te

vërtetohet fakti se këto materiale i takojnë kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Besian Mustafa, për arsye se këtë numër e kanë edhe subjektet tjera dhe se ankuesi nuk ka dorëzuar prova tjera që mund ta bindin panelin se ky numër i përketë kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Besian Mustafa.

Paneli erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitësit të ankesës, janë të paqëndrueshme dhe bazuar në arsyet e theksuara më lartë, dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.205/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesues i Panelit**  
Zyhdi Haziri



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***